



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 6 Prill 2021

Nr. 202

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit me nr ID 2019, të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Këshillit të Ministrave
- Kërkues:** Partia Demokratike
- Ndaj:** Këshillit të Ministrave
- Baza Ligjore:** Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

**I.Vlerësimi paraprak**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1596 prot., datë 01.03.2021, nga Partia Demokratike është raportuar një denoncim ndaj Këshillit të Ministrave, me pretendimin se, nëpërmjet VKM-së nr. 1185, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e metodologjisë dhe të procedurave të monitorimit të qarkullimit në fushën e hidrokarbureve”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 27 datë 19.02.2021, qeveria jep me koncesion shërbimin e monitorimit dhe qarkullimit



të transaksioneve në sektorin e hidrokarbureve me vlerë prej 100 milion euro dhe kohëzgjatje 10 vjeçare, në kundërshtim me vendimin nr. 9 të datës 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur kallëzimit, Partia Demokratike gjithashtu ka depozituar në cilësinë e aktit provues VKM-në përkatëse, objekt kallëzimi.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Ky vendim, në nenin 3, pika 4 të tij, përcakton se “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritet publik privat (PPP), për të



*cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor”.*

Më datë 01.03.2021, me shkresën nr. 1596 prot., pranë KQZ-së është depozituar kallëzimi nga Partia Demokratike, në të cilin pretendohet se:

Këshilli i Ministrave në datën 24.12.2020 ka miratuar një VKM në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Referuar denoncimit të mësipërm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2020 prot., datë 15.03.2021, i ka kërkuar z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm, informacion sqarues, lidhur me këtë nismë nënligjore.

Me shkresën nr. 1427/1 prot., datë 29.03.2021 Sekretari i Përgjithshëm, z. Engjëll Agaçi, ka kthyer përgjigje në të cilën parashtron argumentat përkatëse, për këtë nismë nënligjore, të pretenduar nga Partia Demokratike si në kundërshtim me vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në përgjigjen e dhënë bëhet e ditur se, vendimi nr.1185, datë 24.12.2020 i miratuar nga Këshilli i Ministrave *“Për përcaktimin e metodologjisë dhe të procedurave të monitorimit të qarkullimit në fushën e hidrokarbureve”* nuk parashikon dhënien me koncesion të shërbimit të monitorimit dhe qarkullimit të transaksioneve në sektorin e hidrokarbureve me vlerë 100 milionë dhe kohëzgjatje 10 vjeçare ashtu sikurse Partia Demokratike pretendon, por përcakton procedurat dhe modalitetet konkrete të fiskalizimit të transaksioneve tregtare në sektorin e hidrokarbureve, si një sektor i veçantë i ekonomisë. Referuar përgjigjes së tyre, përmbatja e këtij vendimi, si në formë të përgjithshme por edhe në çdo dispozitë të tij është e karakterit rregullues dhe procedural dhe nuk përcakton asnjë nga përfitimet e ndaluara sipas pikës 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

### III. Analiza ligjore

Referuar nenit 3, pika 4, të Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, parashikohet se: *“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritet publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor.”*



Lidhur me rastin objekt kallëzimi, data e miratimit të kësaj VKM-je është pikërisht në datën kur vendimi nr 9/2020 u miratua nga Komisioni Rregullator. Referuar nenit 104 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" "Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve."

Në vlerësim të provave dhe faktet e sipërpërmenduar, Komisioneri çmon se:

- a) Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në KQZ dalë në zbatim të kërkesave të neneve 91 dhe 92 të Ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar është publikuar në faqen e internetit në KQZ me datë 26.12.2020.
- b) Me shkresën nr. 2616 datë 24.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka dërguar për njohje Kryeministrit, vendimin nr 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Kështu, në datën kur Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 1185, ky institucion nuk ishte njohur ende me përmbajtjen e aktit të sapomiratur nga Komisioni Rregullator në KQZ.

Gjithashtu, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se ky vendim është në shkelje të kushtit tjetër të përcaktuar në nenin 3, pika 4 të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, dhe të përbëjë *kontratatë publike të koncesionit/partneritet publik privat (PPP)*. Si nga përmbajtja e VKM-së ashtu provat e administruara nga palët, nuk konstatohet në asnjë moment as vlera e këtij koncesioni, as kohëzgjatja e tij, ashtu sikurse pretendohet nga denoncuesi, Partia Demokratike. Gjithashtu, emri i përfituesit të këtij koncesioni, referuar po VKM-së së vënë në dispozicion nga Partia Demokratike nuk rezulton në asnjë dizpozitë të këtij vendimi.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e Këshillit të Ministrave, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**



Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Këshillit të Ministrave pasi nuk konstatohen shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 6 Prill 2021

Nr. 202

Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror Të Zgjedhjeve ndaj Këshillit të Ministrave